# RAPORT - KAMPIONATI MESDHETAR I GJIMNASTIKËS ARTISTIKE (COMEGYM 2025)

## 1. Përmbledhje

Federata e Gjimnastikës së Kosovës mori pjesë për herë të parë në Kampionatin Mesdhetar të Gjimnastikës Artistike (COMEGYM), i mbajtur më 05–07 tetor 2025 në Turqi.
Federata Turke e Gjiamnastikës ishte organizatore e këtij edicioni të kampionatit mesdhetar të gjimnastikës. Kosova u përfaqësua në kategorinë Juniore Femra me tri gjimnaste: Sara Pllana, Rea Berisha dhe Bora Hoti.
Dy prej gjimnasteve arritën kualifikimin në finale, e që është sukses i madh për paraqitjen e parë të Kosovës në këtë kampionat. Përzgjedhja e ekipit u bë nga selektoret e ekipit, duke u bazuar në rezultatet e gjimnasteve gjatë garave të deritanishme.
Para garës, ekipi kishte mundësi ti kryente dy seanca stërvitore, e para me date 03 tetor ku gjimnatet mbajten trajnim të hapur, dhe seanca e dytë stërvitore ishte me date 04 tetor, trajnim zyrtar (podium training) në orarin e caktuar nga organizatori.

Lokacioni i garës: Emek, General Eşref Bitlis Cd. no:26, 34785 Sancaktepe/İstanbul, Türkiye



## 2. Përbërja e ekipit

Gjimnastet:
Sara Pllana: Juniore
Bora Hoti: Juniore
Rea Berisha: Juniore

Shtabi Teknik:
Selektore / Trajnere: Doruntinë IbrahimiSelektore / Trajnere: Abeliana BreguDoktoreshë e ekipit: Blerina Mema

## 3. Udhëtimi dhe akomodimi

Fluturimi – Shkuarja

- Data: 03 tetor 2025
- Linja ajrore: Turkish Airlines
- Numri i fluturimit: TK 1018
- Koha e nisjes: 09:15 – Prishtina (PRN)
- Koha e mbërritjes: 12:05 – Stamboll (IST)
- Kohëzgjatja: 1 orë 50 minuta (non-stop)

Fluturimi – Kthimi

- Data: 08 tetor 2025
- Numri i fluturimit: TK 1019
- Koha e nisjes: 18:55 – Stamboll (IST)
- Koha e mbërritjes: 19:35 – Prishtina (PRN)
- Kohëzgjatja: 1 orë 40 minuta (non-stop)

Pas mbërritjes në aeroportin e Stambollit, ekipi u prit nga vetura zyrtare e organizatorëve, e cila siguroi transferin direkt deri te lokacioni i garës dhe hoteli.
Hoteli ka qenë i lidhur me objektin e garës, duke ofruar qasje të drejtpërdrejtë për ekipin.
Ekipi i Kosovës ishte tashmë i familjarizuar me këtë kompleks, pasi ka marrë pjesë më parë në kampe stërvitore dhe gara ndërkombëtare të organizuara në të njëjtin object, siq është Kampionati Ballkanik 2022 dhe 2023. Kjo ka kontribuar në lehtësimin e lëvizjes, orarit të përgatitjeve dhe menaxhimit të garës.Ekipi u akomodua në dhoma dyshe. Ushqimi ishte në katin 8 dhe ishte ushqim cilësor për sportista.

## 4. Rezultatet – Kualifikimet

| Emri | Grupmosha | Kërcime | Paralele | Tra | Parter | Totali (4-garësh) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Sara Pllana** | Juniore | 12.033 | 8.200 | 10.600 | 11.600 | **42.433** |
| **Bora Hoti** | Juniore | 11.633 | 8.700 | 9.400 | 11.066 | **40.799** |
| **Rea Berisha** | Juniore | 10.400 | 7.900 | 8.933 | 10.233 | **37.466** |

## 5. Rezultatet - Finalja

| Emri | Grupmosha | Kërcime | Paralele | Tra | Parter |
|---|---|---|---|---|---|
| **Sara Pllana** | Juniore | 11.825 : Vendi i pestë | - | 11.250 : Vendi i pestë | 12.250 : Vendi i pestë |
| **Bora Hoti** | Juniore | - | - | - | 10.500 : Vendi i tetë |

Kosova garoj shumë mire duke u rënditur e katërta në garën ekipore me 83.232 pikë.



| | Takım<br>Team | Floor Exercises<br>FX | Vault Table<br>VT | Uneven Bars<br>UB | Balance Beam<br>BB | Toplam Puan<br>Total Score |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Italy | 23,800 | 26,266 | 22,600 | 25,633 | **98,299** |
| 2 | Türkiye | 23,866 | 24,966 | 22,299 | 23,999 | **95,130** |
| 3 | Egypt | 22,533 | 24,399 | 22,600 | 21,466 | **90,998** |
| 4 | Kosovo | 22,666 | 23,666 | 16,900 | 20,000 | **83,232** |
| 5 | Algeria | 20,766 | 24,133 | 16,933 | 15,866 | **77,698** |
| 6 | Lebanon | 17,900 | 21,733 | 15,733 | 14,933 | **70,299** |
| 7 | Malta | 10,733 | 12,500 | 10,300 | 12,333 | **45,866** |
| 8 | Syria | 9,566 | 10,166 | 6,866 | 9,200 | **35,798** |
| 9 | Tunisia | 9,800 | 11,700 | 2,466 | 7,933 | **31,899** |

## 6. Përfundim

Pjesëmarrja e Kosovës në **COMEGYM 2025** shënon një moment historik për gjimnastikën vendore. Finalet e arritura nga dy gjimnastet tona përbëjnë sukses të rëndësishëm dhe dëshmi e progresit të vazhdueshëm të ekipit tonë kombëtar.
Gjimnastet nuk morën ndonjë lëndim në garë.

Federata e Gjimnastikës së Kosovës falënderon trajneret, ekipin mjekësor, gjimnastet dhe bashkëpunëtorët për paraqitjen e dinjitetshme në arenën mesdhetare.

***Rezultatet e plota të garës mund të gjenden në linkun:***
***https://fgjk-kos.com/garat-nderkombetare/***

**Foto nga aktiviteti:**
















**FGJK – KGF**

**Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com**




FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION
FGJK - KGF

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË
DHE SPORTIT

*Data e raportit: 18 Nëntor 2025*

**FGJK – KGF**

**Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com**